

PKR.nr.15/18

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Zahide Rexhepi, ne ceshtjen penale te te pandehurit H.A. nga fshati ..., K. ..., per shkak te vepres penale mbajtje ne pronesi, kontroll, ose posedim te paautorizuar te armeve, nga neni 374.p.1 te KPRK-se, e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krimet e Renda, PP/ I. nr. 7/2018, e dt. 15.01.2018, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 01.03.2018, shpalle:
AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit H.A. nga babai F. dhe e ema H., e lindur Z., i lindur me dt. Data e lindjes... ne fshatin ... K. ... ku edhe jeton, ka te kryer shhkollen e mesme, I martuar, baba I pese femive, I gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas I R, te Kosoves,

ËSHTE FAJTOR

Në kohë të papërcaktuar, ka siguru dhe mbajtë në pronësi, në mënyrë të paautorizuar, perkatsisht pa leje nga organi kompetente armën e zjarrit dhe atë një pushke gjuetie me nr. serik ... dhe ... cope fisheke te kalibrit 12, se ciles i ka skaduar afati i lejes se perdorimit ne vitin 2012, e qe edhe me date 28.12.2017, me rastin e kontrollimit te shtepis se tij, e njejta arme dhe municion i gjenden, dhe i jan konfiskuar nga ana e pjestarve te Policis se Kosoves.

-me c' raste ka kryer vepren penale, mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374.par.1.te KPRK-se.

-Andaj, ne baze te nenit 4,7,41,42,43, 46, te KPRK, dhe nenit 233, 365 dhe 450 te KPPRK, se

E GJYKON

Me denim gjobe ne shume prej 250 (dyqind e pesedhjete) euro, te cilen gjobe do ta paguaj, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Detyrohet I pandehuri H.A., që kesaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogaritëse përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet arma, një pushkë gjuetie me nr. serik ... dhe ... cope fisheke të kalibrit 12, e konform nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-së

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt.7/2018, ka ngritur aktakuzën PP/I, nr. 7/2018, ndaj të akuzuarit H.A., për shkak të veprës penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me dt. 01.03.2018, ka mbajtur seancën fillestare, në të cilën I pandehuri H.A. dhe mbrojtësi i tij Av. V.I. kanë qëndruar në tërësi pranë marrëveshjes së arritur me PTH-DKR në Gjiilan, të datës 26.01.2018 me nr PP.I.nr.7/2018.

Prokurori i shtetit Shaban Spahiu ka mbetur në tërësi pranë marrëveshjes me shkrim në PTH-Gjiilan, PP.I 7/2018 e datës 26.01.2018, meqëse marrëveshja është bërë me autorizim të prokurorit të PTH në Gjiilan, ashtu që janë marrë veshë që të pandehurit të shqiptohet një dënim me gjobë në shumën prej 250 euro, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së. po ashtu të shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi i armës së zjarhtë dhe municionit.

Gjykata pas marrjes së mendimit nga ana e të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit, ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, duke e pranuar edhe sanksionin e paraparë për të pandehurin, dënimim me gjobë në shumën prej 250 euro.

Sa i përket armës së zjarhtë ajo është konfiskuar, konform nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-së. I pandehuri është detyruar që kësaj gjykate të paguaj paushallin prej 20 euro ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaritëse përfundimtare të kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**

Me

dt.

01.03.2018

**Sek. Jurdike,
Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit:
Naser Maliqi**

KSHILLA JURIDIKE: kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.